




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.120/2024  
Datë: 23 prill 2024

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 24 par 1 pika 1.1, nenit 25 par 7 të Rregullores Nr.15/2022 për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin Transferimin, Trajnimet dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës të Bashkëpunëtorit Profesional, në takimin 325, të mbajtur me datë 23 prill 2024, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e znj. Ardita Hoti - Sertolli, bashkëpunëtore profesionale, për transfer të përhershëm nga Gjykata Themelore Prishtinë, në Gjykatën Themelore Gjakovë - dega Malishevë
- II. Znj. Hoti - Sertolli, do të filloj punën në Gjykatën Themelore në Gjakovë - dega Malishevë Kosovë, nga data 1 maj 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 23 prill 2024.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e datës 27 nëntor 2023, ka marrë vendim KGJK.nr.526/2023 për shpallje të shprehje të interesit për transferimin e përhershëm të bashkëpunëtorëve profesional në gjykatat themelore/ degë. Për të shqyrtuar kërkesat e bashkëpunëtorëve profesional, dhe për të vlerësuar plotësimin e kushteve për transfer, Këshilli ka themeluar Komisionin për trajtimin e kërkesave të tilla.

Komisioni, pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së znj. Hoti - Sertolli, duke e marrë për bazë si përparësi, vlerësimin e performancës, kohëzgjatjen e përvojës së punës si bashkëpunëtore profesionale dhe largësinë e udhëtimit nga vendbanimi, i ka rekomanduar KGJK-së, të aprovoj kërkesën për transfer.

Këshilli, në takim të datës 23 prill 2024, e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit dhe e ka aprovuar kërkesën për transfer.

Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Znj. Ardita Hoti – Sertolli;
- Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit.